



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 9**

Prishtinë, më 7.02.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i Komisionit, Xhelal Sveçla e Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli dhe Mufera Sernica Shinik, Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Slobodan Petrović dhe Duda Balje.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetović, (OSBE), Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: kordinatore - Natasa Prica-Tishma zyrtare e lartë e fushës-Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit -*Igor Simiq*.

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.01.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

Kryetari, në fillim, ai informoi anëtarët e Komisionit se në bazë të vendimit Nr 06-V-045, me datë 26.1.2018, Kryesia lëshon një vendim të ri, me tekstin si në vijim; Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të plotësohet edhe me 3 (tre) anëtarë, Haxhi Shala, nga GP Nisma për Kosovën, Sllobodan Petroviq, deputet i komunitetit serb dhe Veton Berisha, deputet nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.

Neni 69, pika 7 e Rregullores së Punës së Kuvendit thotë se Kryetari i Kuvendit mund të emërojë anëtarët e komisionit dhe deputetëve pa pasur një grup parlamentar, por pa të drejtë vote.

Ai veçoi, se Vendimi i Kryesisë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, element ky që kërkon interpretim ligjor dhe për këtë arsye GP Lista Serbe, ka vendosur të paraqes shkresë, të cilën do ta procedojë më tej.

Veton Berisha, theksoi se është i drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me Rregullore të Kuvendit, fakt ky që deputetëve ju mundësohet e drejta të jenë pjesë në një apo më shumë Komisione . Kam parashtruar kërkesën që të jem anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesa e Komuniteteve dhe Kthim, për qëllim që të ngritë çështjen e komunitetit që përfaqësojë, edhe pse nuk jam anëtarë i ndonjë grupi parlamentar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.01.2018;

Kryetari, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së Komisionit të mbajtur me dt. 30.01.2018, miratohet njëzëri, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;

Kryetari, veçoi se Raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, përmban tri lloj amendamentesh. Lidhur me mënyrën e votimit dha dy propozime: të votohen amendamentet një nga një apo të votohen në grup. Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit u deklaruan që Raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL të votohen në grup.

Kryetari, fillimisht hodhi në votim amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe konstatoi se Komisioni miratoi të njëjtat, pa ndryshime.

Gjithashtu, hodhi në votim amendamentet e propozuara të deputetit Korab Sejdiu dhe Mimoza Kusari, dhe komisioni vendosi që të njëjtat të miratohen sipas vlerësimit të cilin e merr Komisioni FunkSIONAL.

Kryetari, theksoi se në këtë Projektligj, edhe GP i Listës Serbe ka paraqit amendamente dhe Komisioni FunkSIONAL nuk ka dhënë pëlqimin për miratim të njëjtave, prandaj, ne si përfaqësues të komunitetit serb nuk jemi dakord dhe këto janë arsyeet pse nuk do të votojmë Projektligjin dhe raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari, hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, dhe 2 (dy) Kundër, dhe nxorri këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet kryetari i Komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 7.2.2018, shqyrtoi Projektligjin nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe të njëjtat u miratuan me shumicë të votave.

Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Listës Serbe, të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funkcional.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funkcional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe konstaton se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme.

Veton Berisha, e informoi Komisionin se në mandatin e kaluar ka qenë anëtar i këtij komisioni dhe se ka ngritur çështjen e procedimit të nismës legislative të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

Konsideron se ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës nr. 03/L-064, ka për qëllim të përcaktohen ditët festave edhe për komunitetin egjiptian, e drejtë e cila është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ai shtoi, se grupi punues, ka përfunduar të gjitha obligimet, dhe në bashkëpunim me anëtarët e komisionin janë nxjerr rekomandime. Raporti përfundimtar është proceduar për shqyrtim në Kryesi,, me datë 19 prill 2017. Dha sqarime shtesë, se i njëjti nuk është miratuar, pasi në të njëjtën ditë është shpërbërë Parlamenti.

Ai dha propozoim konkret që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të fillojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit u pajtuan që kjo çështje të shqyrtohet në mbledhjen e radhës, me qëllim që të fillohet procedimi i nismës legislative të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në ora 14.00

Përgaditur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetar i Komisionit,

Igor Simiq